

## STATUT I SHOQËRISË

### “TOTO AUTO” Sh.P.K.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 07.05.2024, z. Elsido Sani, shtetas Shqiptarë, i biri i Luan dhe Vjollca, i ditëlindjes 22.03.1992, lindur në Kuçovë, dhe banues në Rruga Dalip Topi, mbajtës i letërnjoftimit me numër. Personal J20322096L, në perputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshem në Republikën e Shqipërisë, miratoi këtë Statut si vijon:

#### KAPITULLI I THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA

##### - OBJEKTI – KOHEZGJATJA

###### Neni 1

###### Themeli, Emri dhe Forma

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqërise është “**TOTO AUTO**” shpk.

Shoqëria “**TOTO AUTO**” shpk, eshte një person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” (me pas refeuar si “Ligji Tregtar”) ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (SH.P.K.).

Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Regjisitimit (me pas refeuar si “QKR”) ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet pergjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimitarise se saj.

Ortaket e Shoqerise do te jene pergjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

### **Neni 2**

#### **Selia**

Shoqeria do ta kete seline e saj ne adresen: Rruga Mahmut Fortuzi, Pallati Arens, Njesia Administrative nr.9, Tiranë, Shqipëri.

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 3**

#### **Objekti**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë sa vijon: shit - blerje automjetesh, dhënie e automjeteve me qira dhe cdo veprimtari tjeter të ligjshme. Gjithashtu për të realizuar objektin e qëllimet e saj, shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, që i vlereson te dobishme apo të nevojshme për arritjen e qellimeve të saj.

Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm.

Objekti i aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kete Statut.

### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqerise eshte e pakufizuar. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe me një vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI – KUOTAT**

## **Neni 5**

### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 ALL (njëqind Leke). Kapitali themeltar perbehet nga 1 (nje) kuote me vlore nominale 100 leke, qe perfaqeson 100% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise, qe eshte paguar dhe zoterohet teresisht nga ortaku themelues.

Ortaket jane pergjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

## **Neni 6**

### **Kuotat**

#### **Te drejtat dhe detyrimet e lidhura**

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Pronesa mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen perjegjesine e Administratoreve ("Regjistri i Ortakeve").

Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotes qe zoterohet nga cdo Ortak; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

## **Neni 7**

### **Transferimi i Kuotave**

Kuotat mund te transferohen lirisht, pas miratimit te dhene nga Asambleja e Ortakeve me shumice te zakonshme.

## **Neni 8**

### **Zmadhimi i Kapitalit**

Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji. Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit

te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes brenda 20 (njezet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.

Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

#### **Neni 9**

##### **Zvogelimi i Kapitalit**

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

### **KAPITULLI III ORGANET E SHOQERISE**

#### **Neni 10**

##### **Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve**

Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoquerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te Shoquerise:

- a) percaktimi i politikave tregtare;
- b) ndryshime te Statutit;
- c) emerimi i Administratoreve;
- d) emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoquerise;
- g) shperndarjen e fitimeve vjetore;
- h) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoquerise;

- i) pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
- k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- l) miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
- m) çeshtje te tjera sipas parashikimeve te bera prej ketij Statuti.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 14 (katermbedhjete) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbate edhe vendimet e propozuara per çdo çeshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çeshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të

votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njojur ortakeve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut te interesuar / perkates.

Për sa kohe që shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm, kompetencat e asamblesë së ortakëve ushtrohen nga ortaku i vetëm.

Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te registrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e një kopjeje te tij.

### Neni 11

#### Organi Administrues / Administratoret

Organi Administrues perbehet nga 1 (nje) Administrator që emerohet e shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.

**Klea Lilaj**, shtetase Shqiptare, e bija e Viktor dhe Marisela, e ditëlindjes 07.12.1998, lindur në Kuçovë, dhe banuese në Lagjia nr. 1, Blloku "Tafil Skendo", Rr. Kongresi i Lushnjes; Nd: 30, H.2. Ap 100, Kuçovë, mbajtse e letërnjoftimit më numër. Personal J86207047Q, caktohet Administrator i parë i shoqërisë me mandat 5 vjeçar:

Administratori perfaqeson Shoqerine sipas parashikimeve te Statutit.

Administratori do te:

- i. administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve;
- ii. perfaqesoje Shoqerine;
- iii. kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabel;
- iv. pergatise dhe nenshkrue bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- v. krijoje nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- vi. kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
- vii. raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;
- viii. kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
- ix. therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti.

Administratori mund te autorizoje persona te tjere per te vepruar ne emri dhe per llogarine e tij, duke specifikuar / percaktuar kategorine e akteve dhe veprimeve qe perfaquesuesi mund te kryeje.

Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime te kompetencave te administrimit.

Neni 12 Kontrolli i Shoqerise



Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeroje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

## KAPITULLI IV

### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

#### Neni 13

##### Viti Financiar

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

#### Neni 14

##### Rezerva Ligjore

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

#### Neni 15

##### Dividendet

Pas miratimi te bilancit vletor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

## KAPITULLI V PRISHJA - LIKUIDIMI

#### Neni 16

##### Prishja e Shoqerise

Shoqeria prishet (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimitari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimitarise ne QKR; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsyte te tjera te parashikuara ne ligj

**Neni 17**

**Likuidimi**

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

**Neni 18**

**Dispozita Perfundimtare**

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.

Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrerhit gjykesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.

Ky Statut nenshkruehet rregullisht ne 3 (tre) kopje originale ne gjuhet Shqipe

**ORTAKU THEMELUES**

**ELSIDO SANI**

